



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organ Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanes) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. Nr. 17/23

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga panelisti individual, Agon Ramadani Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik, OE "Pro Medical" sh.p.k, me seli në Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizime Mjekësore për Nevojat e QKMF-së", me numër të prokurimit: 623-22-11331-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Kuvendi Komunal Rahovec, më datën 27.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar, ankesa e datës 14.10.2022, e GOE "Pro Medical" sh.p.k, me seli në Prishtinë, (Nr.17/23), e parashtruar kundër Vendimit të AK, të datës 08.12.2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizime Mjekësore për Nevojat e QKMF-së", me numër të prokurimit: 623-22-11331-1-2-1, kurse Vendimi i cituar si më sipër i AK Anullohet, ndërsa aktiviteti i prokurimit për LOT 1 kthehet në Rivlerësim, ndërsa për LOT 2 mbetet në fuqi vendimi i datës 08.12.2022.

II. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj me shkrim OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, të precizuar si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij vendimi, në të kundërtën OSHP ka të drejtë të ndërmarr masa për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

III. Lejohet kthimi i mjeteve të deponuara me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse Ankuesi ka të dejtë që në afat prej 60 (ditëve) të parashtrroj kërkesë për kthimin e mjeteve, në të kundërtën të njëjtat konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 06/01/2023, ka pranuar ankesë nga OE “Pro Medical” sh.p.k, për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizime Mjekësore për Nevojat e QKMF-së”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues-Kuvendi Komunal Rahovec, ankesë kjo e protokolluar nga OSHP me numër të protokollit 17/2023.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapuar, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 15,400.00 €.

Për aktivitetin prokurimit në fjalë Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal Rahovec me datën 08.12.2022, ka publikuar njoftim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, ku është rekomanduar për kontratë:

Lot I OE Madekos sh.p.k vlera 8,990.00 Euro

Lot II OE Por Mecical sh.p.k vlera 2,995.00Euro

Lot III OE Madekos sh.p.k vlera 1,190.00Euro.

Me datë 08.12.2022 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues me datë 13.12.2022, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim. Me datë 20.12.2022 AK ka publikuar Letrat Standarde. Me datë 25.12.2022 OE ankues i ka parashtruar dy kërkesa për rishqyrtim, për Lot I dhe II me datë 27.12.2022 AK-Kuvendi Komunal Rahovec, e refuzon si të pa pabazuar kërkesën për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik “Pro Medical” sh.p.k përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 23 janar 2023 me raportin e ekspertizës. AK Kuvendi Komunal Rahovec është deklaruar se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, ndërsa OE ankues “Pro Medical” sh.p.k me datë 26 janar 2023, ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 23.01.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa e OE ankues “Pro Medical” sh.p.k me seli në Ferizaj të refuzohet si e pa bazuar,
- të mbetet në fuqi vendimi i AK i datës 08.12.2022, (vendim për dhënie të kontratës).

- Seanca shqyrtuese -

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore.

- Konstatimet dhe përfundimet e panelit shqyrtues -

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe analizimit të të gjitha provave të aktivitetit të prokurimit, analizimit të tyre, pretendimeve reciproke të palëve, përfshirë raportin e ekspertit shqyrtues, konstaton se pretendimet ankimore të OE ankues i klasifikon si të bazuara dhe se nuk mbështet raportin e ekspertizës sepse PSH konsideron se të gjeturat e tij dhe rekomandimi në të nuk janë në harmoni me dispozitat e LPP-së.

Vlen të theksohet se pretendimet kryesore mbi bazën e të cilave është ushtruar ankesa, konsistojnë në faktin se AK e ka eliminuar Ankuesin sepse i njëjti nuk ka dorëzuar autorizimin nga prodhuesi konform DT, konkretisht në autorizimin e dorëzuar mungon numri i aktivitetit të prokurimit relevant.

Parashtruesi i ankesës ka prezantuar autorizimin e Prodhuesit lidhur me LOT 1, i lëshuar nga prodhuesi “sinohero”, valid deri me datë 23.07.2023 në të cilin janë të dhënat e OE ankues e poashtu autorizim-dhënësit e gjithashtu produktet për të cilat OE ankues autorizohet, andaj mungesa e numrit të aktivitetit të prokurimit nga paneli konsiderohet se nuk mund të jetë shkak i eliminimit nga aktiviteti, për faktin se nisur nga ky aspekt, PSH vlerëson se ankuesi e plotëson kërkesën e kualifikimit, në kuptim të pikës 1, të FDT, lidhur me autorizimin si pjesë përbërëse e dokumentacionit të tenderit, andaj eliminimi mbi bazën e tillë nga PSH konsiderohet si i paqëndrueshëm gjithashtu duke u bazuar në frymën e konsistencës me vendimet që objekt shqyrtimi kanë pasur situatën e njëjtë në të cilat është vendosur në këtë mënyrë (njëra nga vendimet me situatë të njëjtë, PSH-627/22), andaj në kontekstin e fakteve dhe rrethanave si më sipër PSH konsideron se duhet marrë në konsideratë së paku për faktin parimor se, kërkesa si e tillë si dhe kjo bazë anulimi përveç tjerash do të paraqiste edhe vështirësi drejtuar operatorëve ekonomik për faktin se të njëjtit pa nevojë në këtë formë obligohen që për secilin aktivitet prokurimi të kërkojnë autorizim nga prodhuesi, ndërsa ata veçse janë të autorizuar për produkte të caktuara si dhe për afat kohor të caktuar, kështu që rrjedhimisht duke u bazuar nga të gjitha që u thanë si më sipër e poashtu në tiparet kryesore të LPP-së që janë efikasiteti, ekonomociteti, shfrytëzimi efikas i fondeve publike (me qenë se OE ankues është më i lirë se ai i rekomanduar) u arrit deri tek vendimmarrja sikurse në dispozitiv lidhur me këtë lot, ndërsa në rast të dyshimit të vërtetësisë së autorizimit të lartpërmendur, AK gjatë procedurave të rivlerësimit mund të kërkojë

sqarime apo informata shitesë nga OE apo nga prodhuesi i cili ka lëshuar autorizimin, konform nenit 72 të LPP-së.

Lidhur me LOT 2 të këtij aktiviteti të prokurimit,

Pretendimet ankimore të OE ankues lidhur me lotin 2 konsistojnë në faktin se pa pasur fare kërkesë për rishqyrtim AK ka kthyer këtë lot në rivlerësim duke ndryshuar OE të rekomanduar (tani OE ankues) si dhe duke rekomanduar OE tjetër.

Në kontekstin e fakteve dhe rrethanave të analizuara si më sipër si dhe pas analizimit të veprimeve të ndërmarra nga ana e AK Paneli Shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimor klasifikohet si i bazuar, për faktin se duke u bazuar në të dhënat në e-prokurimi, lidhur me lot 1 nuk ka pasur kërkesë për rishqyrtim, andaj duke konsideruar se secili lot përmban kontratë në vete si dhe ndaj secilit duhet të aplikohen rregullat procedurale veç e veç, veprimi i ndërmarrë nga ana e AK duke kthyer lotin 2 në rivlerësim bie ndesh me LPP, konkretisht nenin 108/A i cili përcakton se duhet të ketë zgjidhje preliminare të mosmarrëveshjeve të rregulluara si procedura ankimi, andaj rrjedhimisht PSH konstaton se AK ka vepruar kundrejt dispozitave ligjore rregulluese duke kthyer lotin 2 në rivlerësim pa pasur fare kërkesë për rishqyrtim për këtë lot, andaj PSH përmes këtij vendimi lëshon vërejtje drejtuar AK-së, që nëse në të ardhmen evidentohen shkelje/gabime të njëjta apo të ngjashme, OSHP në kuadër të paneleve shqyrtuese, OSHP me një shkresë do ti drejtohet KRPP-së, dhe do të kërkojë që të veprojë konform nenit 25, paragrafit 8 të LPP-së.

Andaj duke u bazuar nga të gjitha që u thanë si më sipër, duke qenë se Loti 2 është kthyer në rivlerësim pa pasur kërkesë për rishqyrtim, lidhur me këtë lot PSH konstaton se anulohet vendimi i datës 20.12.2022, ndërsa mbetet në fuqi ai i datës 08.12.2022.

Paneli shqyrtues me marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli Shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues

Agon Ramadani

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Kuvendi Komunal Rahovec

1x1 OE "Pro Medical" sh.p.k, me seli në Ferizaj

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.